

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ M & M Dental ” SHPK**

Personi që do të firmosë më poshtë :

Znj. **Egresa Mavriqi**, lindur në Tiranë më dt. 25/12/1979, e bija e Isufit dhe e Vjollcës, banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Leternjoftimit / Kartë Identiteti Nr.025225158 dhe Nr. Personal : H962250260,

Ka hartuar si më poshtë Aktin e Themelimit të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.P.K.)

Kjo Shoqëri krijohet dhe ushtron aktivitetin e saj në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Legjislacionin që do të jetë në fuqi gjatë aktivitetit të Shoqërisë, Ligjin Nr. 9901, dt. 14/04/2008 për “ Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, Ligjin Nr. 7667, dt. 28/01/1993 për “ Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare “, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që do të jenë në fuqi gjatë gjithë aktivitetit të Shoqërisë.

Neni 1

Shoqërisë është emërtuar : “ **M & M Dental** ” SHPK. Kjo Shoqëri përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së Kapitalit Themeltar të saj.

Neni 2

Selia e Shoqërisë do të jetë në Bulevardin “ Zogu I “, Objekti Nr. 99, Kati II, Tiranë, ndërsa Degë ose Filiale të saj mund të krijojë kudo, Brenda ose jashtë shtetit shqiptar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë për një kohë të pa-kufizuar.
Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, mund të vendosen afate të veprimtarisë.

Neni 4

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është : 2'000'000. Lekë (dymiljon), dhe që përbëhet në vlerë monetare që kap shumën prej: 1'000'000. Lekë dhe në vlerë materiale që kap vlerën : 1'000'000. Lekë.
Ky Kapital është krijuar me kontribut të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, si më poshtë :

- a) Znj. Egresa Mavriqi kontribon në shumën: 2'000'000. Lekë ose në 100 % të Kapitalit Themeltar.

Në bazë të kontributeve të lartpërmendura, Znj. Egresa Mavriqi ka 100 pjese të Kapitalit Themeltar të renditura nga numri i series 1 (një) deri në numrin e serisë 100 (njëqind)

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të shtrihet në këto fusha :

1. *Import & Eksport të Materialeve dhe Pajisjeve Mjekësore;*
2. *Ushtrim aktiviteti në fushën e mjekësisë, hapje të Poliklinikave dhe Laboratorëve Dentarë, si dhe të Qendrave të Edukimit Shëndetësor.*

Shoqëria : “ M & M Dental “ shpk

3. Tregëtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm mjekësorë;

4. Transport i materialeve mjekësore brenda dhe jashtë vendit.

Neni 6

Administrator i vetëm për një periudhë të pa-caktuar, do të jetë Znj. Egresa Mavriqi, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane me dt. 25/12/1979, banuese ne Tiranë, Rr. Sami Frasheri.

Neni 7

Personalitetin juridik Shoqëria e fiton në momentin e regjistrimit te saj si person juridik ne regjistrin tregëtar prane QKB-se (organit kompetent te sanksionuar me ligj), ndersa të drejtën për të vepruar sipas objektit të saj Shoqëria e fiton në momentin e marrjes se lejes per ushtrimin e veprimtarise nga organet tatimore të rrethit perkates.

Neni 8

E gjithë veprimtaria e Shoqërisë do te zhvillohet në bazë te Aktit të Themelimit, Statutit të Shoqërisë dhe dispozitave ligjore dhe nenligjore qe do te jenë në fuqi gjatë gjithë veprimtarise se shoqërisë tregëtare.

Neni 9

Marredheniet e shoqërisë me persona te punesuar prane saj do te rregullohen ne baze te kontrates kolektive dhe individuale te punes qe do te behet me cdo te punesuar ne perputhje me kerkesat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise.

Neni 10

Te gjitha mosmarreveshjet që mund t'i lindin Shoqërisë me persona te tjere kur nuk zgjidhen me mirekuptim, mund te zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar nepermjet Gjykatave ose Arbitrazheve vendas, me perjashtim te marreveshjeve me të huajt kur eshte parashikuar ndryshe.

Neni 11

Shoqëria do të ketë Statutin e saj si dhe vulën përkatëse

Neni 12

Efektet e këtij Akti nisin që në momentin e nënshkrimit të tij nga ana e Ortakut Themelues.

Ortakja Themeluese

Egresa Mavriqi

